



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Nëntor 2016

Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike 2 - 4 nëntor 2016, Expcity Albania, Tiranë, Shqipëri

KONFERENCA DHE EKSPOZITA – VETËM DITË LARG !!



Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike 2016, “Uji dhe Punësimi”, që do të mbahet në 2-3-4 Nëntor 2016, te EXPOCITY ALBANIA, në Tiranë është vetëm ditë larg. Komiteti Organizativ dhe i Programit kanë nderin të ndajnë mëposhtë pjesët më të veçanta çka premtion të jetë programi më i mirë i mbledhur i folësve dhe eventeve të organizuara ndonjëherë nga SHUKALB / SHUKOS. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të Re në SHUKALB!

E RËNDËSISHME: Planifikoni Trajnimin e Stafit tuaj, në Buxhetin e vitit 2017

Është koha që shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime në Shqipëri dhe Kosovë, të planifikojnë në buxhetin e vitit 2017, trajnimin e stafit të operimit dhe mirëmbajtjes. Marrëveshja e Mirëkuptimit që do të nënshkruhet në Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët Ballkanike do të sigurojë një program të përbashkët trajnimi për Shqipërinë dhe Kosovën, dhe që do të



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike!

2-3-4 Nëntor 2016,
Tiranë, Shqipëri

Bashkohuni me Ne!



menaxhohet nga SHUKALB dhe SHUKOS. [lexo më shumë](#)

Ka nisur Kursi i Trajnimit “Plani Biznesit për Përmirësimin e Performancës”



Më 3 tetor 2016, SHUKALB nisi sesionin e parë të kursit të trajnimit, ” Plani Biznesit për Përmirësimin e Performancës”. Kursi është jashtëzakonisht popullor dhe

i rëndësishëm për shoqëritë ujësjellës kanalizimeve pasi ata punojnë për të përgatitur planet e tyre shumëvjeçare të biznesit për periudhën 2017-2021. Meqë kursi është shumë intensiv, kërkon një “skuadër menaxherësh të lartë” nga çdo shoqëri pjesëmarrëse. Çdo kurs kërkon katër seanca gjatë një periudhe dy mujore dhe për këtë arsye në kurs mund të akomodohen vetëm 5 shoqëri. SHUKALB bëri një përpjekje shtesë dhe organizoi dy grupe prej pesë shoqërish UK secila, për të mbështetur sa më shumë shoqëri që të jetë e mundur. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit do të kenë zhvilluar një draft Plan Biznesi për shoqërinë e tyre. [lexo më shumë](#)

SHUKALB Përfaqësohet nga Giantris dhe Ibrahimllari në Kongresi i IWA-së në Brisbane, Australi



Kongresi dhe Ekspozita e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA) u mbajt në 8-13 tetor 2016 në Brisbane, Australi. SHUKALB është një Anëtar Drejtues i IWA-së dhe u përfaqësua në Asamblenë Drejtuese të Anëtarëve nga

Philip Giantris, Drejtor Ekzekutiv i SHUKALB dhe Arlinda Ibrahimllari, Krye Inxhinierë e Departamentit të Shërbimeve të Përpunimit të Ujërave të Ndotur pranë shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Korçë dhe Kryetare e Komitetit Drejtues për Zhvillimin e Udhëheqësve të Ujit të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit. [lexo më shumë](#)



Na tregoni se cfarë mendoni!



SHUKALB dhe SHUKOS Mbështesin Partneritetin e Studimit të Danubit

PARTNERITETI I STUDIMIT TË DANUBIT

Si SHUKALB ashtu edhe SHUKOS kanë vazhduar të tregojnë mbështetjen e tyre për Partneritetin e Studimit të Danubit, i cili është themeluar me mbështetjen e Programit të Ujit të Danubit nga Shoqata Ndërkombëtare

e Kompanive të Furnizimit me Ujë të Basenit të Lumit të Danub (IAWD). Programi i Ujit të Danubit është mbështetur financiarisht përmes granteve bujare nga Qyteti i Vjenës dhe Banka Botërore. [lexo më shumë](#)

Projekti “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri” organizoi Kursin Tre Ditor “Trajnim i Trajnerëve (TiT)”



Në 11-13 tetor Projekti “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri” zhvilloi kursin e parë të “Trajnimit të Trajnerëve (TiT)” për një grup ekspertësh lokalë, të cilët kanë qenë të angazhuar

në fazën e zhvillimit të kursit të trajnimit të Projektit. Kursi TiT u prezantua nga Znj Milena Sauku dhe Znj Lindita Dhima, me përkrahjen dhe këshillën e Ekspertes së Projektit nga SHBA, Znj Nancy Barnes. Kursi TiT është pjesë e Komponentit-I të Projektit dhe do të jepet edhe një herë në vitin e tretë të Projektit, për pjesën tjetër të ekspertëve lokalë. [lexo më shumë](#)

Të tjera

Ditët e EWA Bruksel – Konferenca e 12-të e EWA Bruksel "Politika Ujore e BE-së dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm

Bashkojuni Shoqatës Evropiane të Ujit në Ditët e EWA Bruksel, të cilat do të zhvillohen në 8-9 nëntor 2016. Gjatë dy ditëve të eventeve, EWA ju jep mundësi unike për të marrë

pjesë në temat e nxehta të axhendës Evropiane mbi Politikën e ujit . Organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme për Mjedisin të Komisionit Evropian, objektivi kryesor i Konferencës vjetore të EWA Bruksel është krijimi i një dialogu mes Komisionit Evropian dhe profesionistëve të ujit Evropiane dhe palëve të interesuara.

Për më tepër informacion rreth Konferencës dhe regjistrimit ju lutem vizitoni faqen e internetit: <http://www.ewa-online.eu/calendar-detail/events/12-brussels-conference.html>

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trainimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al